



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISE SKRAPAR

VENDIM

Nr. 12, datë 28. 02. 2023

**“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR DHËNIEN E TITUJVE
VENDORE TË NDERIT NË BASHKINË SKRAPAR”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 28.02.2023, mori në shqyrtim projektaktin e paraqitur nga Kryesia e Këshillit Bashkiak Skrapar në zbatim të Ligjit Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë", nenit 14, nenit 15, pika 1, gërma a), pika 2, neni 17, pika 1, VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 " Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënie dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë", Kreu I,pika 2, ku përcaktohet se: “Komisioni ngrihet me urdhër të autoritetit përgjegjës çdo fillim viti kalendarik”

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit Këshillimor për Dhënie dhe Titujve Vendore të Nderit në Bashkinë Skrapar.
2. Komisioni Këshillimor për Dhënie dhe Titujve Vendore të Nderit në Bashkinë Skrapar, do të përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë si më poshtë:
Znj. Fatmira Hasko
Z. Shkëlqim Zaimi
Znj. Edlira Shkëmbi
Znj. Flora Çela
Z. Klajdi Kadiu
3. Komisioni Këshillimor për Dhënie dhe Titujve Vendore të Nderit në Bashkinë Skrapar i ngritur në zbatim të këtij vendimi do të ushtrojë kompetencat e tij për vitin 2023.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Sekretare Këshillit Bashkiak
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 10 - vota pro , vota kundër - s'ka , votë abstenim - s'ka.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

**KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI**

